



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Nr . . . . . Prot.

Tiranë, më \_\_\_ . \_\_\_. 2018

Lënda: Monitorimi i realizimit të buxhetit të 12- mujorit për vitin 2017

**MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË**

**Tiranë**

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 130, datë 15.12.2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, mbështetur në udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr. 2 datë 06.02.2012, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” si dhe Udhëzimit nr. 22, datë, 17.11.2016 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, po ju paraqesim raportin e monitorimit të buxhetit për periudhën 12-mujore për vitin 2017.

**Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**, për vitin 2017 i janë akorduar fondet buxhetore, sipas tetë programeve të miratuara për sistemin e bujqësisë dhe të ushqimit, konkretisht:

- ❖ Planifikim, Menaxhim dhe Administrim
- ❖ Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit
- ❖ Infrastruktura e Kullimit dhe Ujitjes
- ❖ Zhvillimi Rural duke Mbështetur Prodhimin Bujqësor, Blegtoral, Agroindustrial dhe Marketingun
- ❖ Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor
- ❖ Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës Bujqësore
- ❖ Mbështetja për Peshkimin
- ❖ Administrimi i Ujrave

Buxheti 12 mujor 2017, i planifikuar për këto 8 programe, është realizuar në masën 95 % ndaj planit vjetor përfundimtar dhe paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Buxheti vjetor fillestar ishte 10.171 milion lekë dhe me shtesat kryesisht si fond i veçantë, plani përfundimtar është 8.027 milion lekë dhe është realizuar në shumën 7.640 milion lekë.


Gjatë këtij viti, realizimet për shpenzime korrente janë 95 %, investimet në total 95 %, nga këto financimi i huaj 96 %, Kosto Lokale 100 %, T.V.Sh 90 % dhe Investimet në objekte 91%.

I detajuar realizimi 12 mujor sipas programeve paraqitet në tabelën e mëposhtme;

N r	Emri i Programit	Buxhet i 2017	Struktura Në %	Fakti 12-mujor 2017		
				Në mln lekë në %	Në % ndaj buxh	Struk
1	Planifikim, Menaxhim, Administrim	271	3.4	260	96	3.4
2	Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit	1.841	22.9	1.679	91	22
3	Infrastruktura e Ujitjes, Kullimit	2.770	34.5	2.722	98	35.6
4	Zhvillimi Rural duke Mbështetur Bujqësinë, Blegtorinë, Agroindustrinë dhe Marketingun	2.525	31.5	2.413	96	31.6
5	Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor	216	2.7	206	95	2.7
6	Menaxhimi i Tokës Bujqësore	25	0.3	25	100	0.3
7	Mbështetja për Peshkimin	114	1.4	94	82	1.2
8	Administrimi i Ujrave	266	3.3	241	91	3.2
	<b>Totali</b>	<b>8.028</b>	<b>100</b>	<b>7.640</b>	<b>95</b>	<b>100</b>

Në realizimin si 12- mujor në nivelin 95 % ndaj planit, peshën më të madhe e zë programi buxhetor “Infrastruktura e ujitjes dhe kullimit” me 35.6 %, pasuar nga programi “Zhvillimi Rural duke Mbështetur Bujqësinë, Blegtorinë, Agroindustrinë dhe Marketingun” me 31.6 %, programi “Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit” me 22 %, programi “Planifikim Menaxhim dhe Administrim” me 3.4 %, programi “Administrimi i Ujërave” me 3.2 %, programi “Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor” me 2.7 %, programi buxhetor “Mbështetja për Peshkimin” me 1.2 %, dhe programi “Menaxhimi i Tokës Bujqësore” me 0.3 %.

Struktura e shpenzimeve të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për çdo program, sipas PBA-së, buxhetit të vitit 2017 dhe realizimit faktik të 12–mujorit të vitit 2017, jepet në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm.



### Monitorimi i shpenzimeve, sipas programeve

#### 1. Programi “Planifikim, Menaxhim, Administrim”

Realizimi i shpenzimeve të 12- mujorit të vitit 2017 për këtë program, që përfaqëson rreth 3.4 % të realizimit të kësaj ministrie, sipas zërave kryesorë krahasuar me planin vjetor, rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet korente                      99 përqind
- Shpenzimet kapitale                    0 përqind
- **Gjithsej                                      96 Përqind**

Për vitin 2017, janë parashikuar 5 produkte në këtë program, të cilat rezultojnë të plotësuara si më poshtë.

Produkti	Buxheti 2017 në mln lekë	Realizimi faktik i 12- mujorit 2017		
		Në milionë lekë	Në %	Statusi i realizimit
Kapacitetete menaxhuese dhe implementuese ne Institucion te trajnuara dhe mirefunksionale per hartimin dhe	156	155	99	plotesisht
Kushte pune te permiresuara e ne funksion te plote per permbushjen e detyrave	7	0	0	plotesisht
Detyrime vjetore financiare per pjesemarrjen e Shqiperise ne organizmat nderkombetare	34	33	97	plotesisht
Aftesi ne rritje te stafit permes trinineve te ndryshme e nevojshme	14	14	100	plotesisht
Materiale dhe sherbime te pergjitheshme zyre, shpenzime transporti, udhetime brenda dhe jashte vendit dhe te tjera	60	58	97	plotesisht
<b>TOTALI</b>	<b>271</b>	<b>260</b>	<b>96</b>	

## 2- Programi “Siguria Ushqimore”

Politika në fushën e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit synon përmirësimin e kuadrit ligjor duke e përshtatur atë me legjislacionin e BE-së, hartimin dhe zbatimin e programeve kombëtare të kontrollit të sëmundjeve në kafshë e parazitëve në bimë, programeve të monitorimit të sëmundjeve, mbetjeve në kafshë dhe në produktet ushqimore me origjinë shtazore, monitorimit të ujërave e molusqeve bivale, identifikimin e kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale, forcimin e karantinës veterinarë e fitosanitare, përdorimin e praktikave të mira në mbrojtjen e shëndetit të bimëve, fuqizimin e rrjetit laboratorik, fuqizimin e inspektimeve mbi sigurinë ushqimore, vendosjen e sistemit të vetëkontrollit dhe informimin në kohë të konsumatorit.

Për periudhën 12 mujore të vitit 2017 janë në proces aktivitetet mbi masat profilaktike veterinarë fitosanitare, programi i monitorimit të mbetjeve në kafshët e gjalla dhe produktet me origjinë prej tyre, monitorimi i ujërave e molusqeve bivalve, identifikimi i kafshëve dhe hedhja e të dhënave në sistemin e informacionit blegtoral dhe veterinar Ruda, luftimi i parazitëve në bujqësi dhe mbështetja e të gjithë aktivitetëve të DB-së dhe AKU-së.

Produktet e përfituara për periudhën 12 mujore parashikuar për PBA-në e vitit 2017, të pasqyruar në aneksin bashkëngjitur janë realizuar si më poshtë:

- Përfundoj fushata e vaksinimit të brucelozës të të gjitha kafshëve të imta mbështetur në strategjinë kombëtare si dhe në bashkëpunim me projektin PAZA “Përmirësimi i mbrojtjes së konsumatorit, për luftimin e sëmundjeve zoonotike” në masën 2.308.533 krerë të imta. Vaksinimi i kafshëve të imta kundër brucelozës zë pjesën më të madhe të shpenzimeve për Drejtorinë Veterinarë.
- Në muajin Maj filloj programi i monitorimit të mbetjeve në kafshë dhe produkteve me origjinë shtazore si dhe programi i monitorimit të molusqeve dhe ujërave të brendshëm.
- Mbështetur në legjislacionin veterinar kombëtar në fuqi si dhe në zbatim të strategjive që rekomandon Evropa në lidhje me masat që duhet të merren për sëmundjen e Dermatozës Nodulare të gjedhit (LSD), si dhe nisur nga fakti se kafshët e ngordhura, janë në fermat e vogla ku këto kafshe janë burimi i mbështetjes ekonomike dhe financiare për këto fermerë, si dhe sigurisht prodhimet që përfitohen nga këto kafshe janë burimi dhe baza e sigurimit të produkteve me origjinë shtazore në këto zona. Dhe këtë vit u ble vakcina kundër LSD me një fond prej 148 milion lekë dhe po vazhdon vaksinimi i të gjitha kafshët të llojit gjedhë. U krye vaksinimi i 312.607 kafshëve të llojit gjedhë kundër sëmundjes të Dermatozës Nodulare, sëmundje kjo që shkaktoj ngordhjen e shumë krerëve gjedhë.
- Janë dëmshpërblyer një numër prej 127 krerë gjedh dhe 8 krerë të imta kundër sëmundjes së plasjes dhe brucelozës.
- Janë realizuar shpenzimet operative 12 mujore, fondi i pagave dhe sigurimet shoqërore sipas parashikimit në buxhetin 2017 për DB-ve, ISUV dhe AKU.
- Janë realizuar sipas parashikimit shpenzime të investimeve në zërat TVSH dhe kosto lokale, pasi kjo lidhet me zbatimin e projekteve në fushën e sigurisë ushqimore dhe veterinarisë, implementimi i të cilave është në proces.

Realizimi i shpenzimeve të 12-mujorit të vitit 2017, për këtë program, që përfaqëson rreth 22 përqind të totalit të buxhetit fakt të kësaj ministrie, sipas zërave kryesorë, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

Shpenzimet korente	93	përqind
Shpenzimet kapitale	76	përqind
<b>Gjithsej</b>	<b>91</b>	<b>përqind</b>

## **Programi “Infrastruktura e Kullimit dhe Ujitjes”**

Gjatë vitit 2017, nëpërmjet programit të Menaxhimit të Infrastrukturës së Kullimit dhe Ujitjes është mundësuar:

### *Me shpenzimet:*

- Janë realizuar punimet e mirëmbajtjes në infrastrukturën e ujitjes me tregues kryesorë pastrimin e rreth 158 km kanale kryesore, duke kontribuar në bërjen funksional të kanaleve kryesore ujtesë në administrim të MBZHR, para fillimit të sezonit të ujitjes, me impakt përmirësimin e ujitjes në rreth 30 000 ha.
- Janë realizuar punimet e mirëmbajtjes në infrastrukturën e kullimit, me tregues kryesorë pastrimin e rreth 220 km kanale kryesore kullues dhe kanalet të ujërave të larta duke ndikuar në përmirësimin e kullimit në një sipërfaqe prej rreth 50 000 ha.
- Këto punime sëbashku me punimet për mirëmbajtjen e hidrovorëve kanë ndikuar edhe në largimin e shpejtë të ujërave nga siperfaqet e përmytura nga lumi Vjosë në dhjetor 2017 dhe shkurt 2018, kryesisht në zonën e Fierit.

### *Me projektet me investimeve është mundësuar:*

- Përmirësimi i kullimit të rreth 3000 ha tokë bujqësore në zonën e Kavajës, që kullojnë nëpërmjet përroit të Draçit. Kjo falë ndërhyrjes për sistemimin e rreth 6 km të përroit të Draçit (faza e parë).
- Përmirësimi i ujitjes në rreth 10 000 ha nëpërmjet rehabilitimit të kanalit kryesorë ujitës Peqin-Kavaje dhe kanalit kryesorë të Skemës ujitëse Milot-Mamurras-Drojë.
- Përmirësimi i mbrojtjes nga përmytja në zonat më të rrezikuara në lumenjtë Kir, Bunë, Shkumbin, Vjosë dhe Devoll, nëpërmjete ndërtimit dhe rehabilitimit të rreth 6.5 km argjinaturë mbrojtëse.
- Me projektin e Burimeve Ujore dhe Ujitjes, të Bankës Botërore (financim i huaj), kanë përfunduar rehabilitimet e 5 skemave ujitëse si më poshtë:
  - Dega Krutje (vetëm me gravitet - Rezervuari Thanë);
  - Dega Tërbuf (vetëm me gravitet - Rezervuari.Thanë);
  - Skema ujitëse Divjake;
  - Skema ujitëse në Rezervuarin Kurjan-Strum (vetëm gravitet);
  - Skema ujitëse në Rezervuarin Koshnicë (vetëm me gravitet);

Me rehabilitimin e këtyre skemave ujitëse, sipërfaqja ujitëse me infrastrukturë të rehabilituar është shtuar me rreth 20 000 ha në zonat Fier, Lushnje, Divjakë dhe Devoll.

Në këtë menyre aftësia ujitëse në fund të vitit 2017 arriti në rreth 225 000 ha në raport me 120 000 ha, që ishte në vitin 2014.

Realizimi i shpenzimeve të 12-mujorit të vitit 2017, për këtë program, që përfaqëson rreth 35.6 përqind të totalit të buxhetit fakt të kësaj ministrie, sipas zërave kryesorë, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

• Shpenzimet korente	94	përqind
• Shpenzimet kapitale	100	përqind
• <b>Gjithsej</b>	<b>98</b>	<b>përqind</b>

#### **4- Programi “Zhvillimi rural duke mbështetur prodhimin bujqësor e blegtoral, agroindustrinë dhe marketingun”.**

Në programin buxhetor të vitit 2017, programit “Zhvillimi Rural në mbështetje të bujqësisë blegtorisë, agroindustrisë dhe marketingut” i janë akorduar gjithsej 2.525 milion lekë dhe përkatësisht:

- Shpenzime korrente	1.069 milion lekë
- Shpenzime kapitale	1.456 milion lekë

Realizimi i shpenzimeve të 12-mujorit të vitit 2017, për këtë program, që përfaqëson rreth **31.6 përqind** të totalit të buxhetit fakt të kësaj ministrie, sipas zërave kryesorë, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

• Shpenzimet korente	98	përqind
• Shpenzimet kapitale	94	përqind
• <b>Gjithsej</b>	<b>96</b>	<b>përqind</b>

Në programin buxhetor të rishikuar të vitit 2017 “Zhvillimi Rural në mbështetje të Bujqësisë, Blegtorisë, Agroindustrisë dhe Marketingut” me gjithë ndryshimet dhe rialokimet e kryera gjatë vitit pati në dispozicion gjithsej **2,525,479.860** mijë lekë dhe në total janë përdorur **2,413,124.730** mijë lekë ose 95.55% të fondeve në dispozicion.

#### Realizimi sipas produkteve:

##### **A. Ruajtja e resurseve gjenetike në fermë.**

Në këtë zë shpenzimesh përfshihen shpenzimet për Përmirësimin Racor në Gjedh si dhe shpenzimet për ruajtjen e racave në rrezik zhdukje tek Bagëtitë e Imta. Gjithsej janë alokuar 6,040 mijë lekë, nga të cilat gjatë vitit 2017 janë shpenzuar 5,526.345 mijë lekë ose 91.5 % e fondit të alokuar.

Mbështetur në VKM nr. 1708 datë 29. 12. 2008 “Për zbatimin e programeve për ruajtjen in-situ të racave autoktone të bagëtive të imta” shoqëruar me rregulloren përkatëse nr. 4 datë 18. 08. 2009, të ndryshuar, për ruajtjen e resurseve gjenetike në fermë u është alokuar Drejtorive të Bujqësisë shuma 5,540 mijë lekë dhe QTTB-së Fushë Krujë shuma 500 mijë lekë: (për Përmirësimin Racor të Gjedhit - regjistrimi i treguesve zooteknikë për racat Holshtejn dhe Xhers në DB-të e 5 qarqeve u alokuar **3,940 mijë lekë**). Gjatë vitit 2017 janë shpenzuar 3,557.58 mijë lekë ose 90.3% e fondit të alokuar. Grumbullohen periodikisht/çdo muaj tregues Zooteknik për 1,912 krerë lopë. QTTB-së Fushë Krujë i është alokuar shuma **500 mijë lekë** për kontroll dhe përpunim të dhënash për treguesit zooteknik të racave të gjedhit dhe janë shpenzuar 417.765 mijë lekë ose 84% e fondit të alokuar.

Për ruajtjen e resurseve gjenetike **në të imëta** janë alokuar **1,600 mijë lekë** dhe janë shpenzuar 1,551 mijë lekë ose 97% e fondit të alokuar. Janë mbështetur 755 krerë të imëta për dy raca në rrezik zhdukje, për delen Shkodrane dhe Larën e Polisit.



## **B. Promovim i produkteve shqiptare të sektorit bujqësor, blegtoral dhe agropërpunimit, përmes pjesëmarrjes në panaire kombëtare dhe ndërkombëtare.**

Alokuar 16,000 mijë lekë dhe shpenzuar 9,218.779 mijë lekë ose 57.62% e fondit të alokuar. Në mbështetje të objektivave të ministrisë për përmirësimin e infrastrukturës së marketingut dhe nxitjen e biznesit vendas për vitin 2017 janë realizuar pjesëmarrje në 2 (dy) panaire promovuese ndërkombëtare ("Green Week, janar 2017", Gjermani dhe "Macfruit", maj 2017, Itali).

Me Urdhër Ministri Nr. 373, datë 31. 08. 2017 "Për përdorimin e fondeve të marketingut për vitin 2017" u planifikua dhe u realizua në muajin Nëntor 2017 aktiviteti promovues me titull "Ofrim shërbimi për organizimin e aktivitetit për promovimin e sektorit bujqësor, viti 2017", me fond limit 7,774,246 (shtatë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e dyqind e dyzet e gjashtë) lekë pa TVSH.

## **C. Mostra të degustuar të duhanit, në drejtim të ruajtjes së shëndetit të konsumatorit.**

Ky produkt është realizuar nga Agjencia Kombëtare e Duhan Cigareve. Për vitin 2017 me buxhetin e rishikuar janë alokuar 32,889 mijë lekë dhe për vitin janë përdorur 31,927.781 mijë lekë ose rreth 97.08% e fondit të alokuar. Nga ky fond, në funksion të këtij produkti ka qenë edhe realizimi i investimit, për rikonstruksionin, pajisjet dhe instalimin e sistemit të mbrojtjes kundër zjarrit, në shumën 1,489.8 mijë lekë. Nga AKDC gjatë këtij viti buxhetor janë degustuar 120 mostra cigaresh dhe janë kryer 104 analiza fiziko-kimike për rreth 312 tregues për produktet e tjera si duhan i grirë, puro, pureta, cigarillo, etj.

## **D. Përfitues të skemave kombëtare.**

Për vitin 2017 për skemat mbështetëse nga rialokimet rezultoi fondi prej 946,426.36 mijë lekë.

*Nga ky fond janë zbritur shumat:*

- 202,256.506 mijë lekë e përdorur për luftimin e mizës së ullirit në 6 Qarqe (Elbasan, Fier, Vlorë, Tiranë, Lezhë dhe Berat, në një sipërfaqe prej 5599.57 ha. Fondi i tenderuar nga Ministria dhe operatori është përdorur në masën 99.67% (ose 201,584.616 mijë lekë). Dhe
- 335,800 mijë lekë përdorur për dëmshpërblimin e fermerëve me lopë të dëmtuara nga dermatoza nodulare dhe janë përdorur 331,703.719 mijë lekë ose në masën 99% e fondit të alokuar, për blerjen e 1912 krerë lopëve që janë shpërndarë tek fermerët e dëmtuar.

Në fondin e mbetur prej 408,369.854 mijë lekësh vetëm shuma prej 202,256.506 mijë lekë është përdorur në funksion të realizimit të produktit "D" sepse pjesa tjetër janë paga, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative në mbështetje të funksionimit të AZHBR si institucion në tërësi.

Gjatë vitit 2017 nga shuma 408,369.854 mijë lekë janë përdorur 406,558.090 mijë lekë ose 99.56% e fondit të alokuar. Ky fond është përdorur për shpenzime mirëmbajtje të institucionit dhe si shpenzime për administratën në funksion të fushatës promovuese, kontrollit të dokumentacionit dhe verifikimit në vend të 5,025 aplikimeve. Fondi në dispozicion të skemave u reduktua në 12% të vlerës së planifikuar për disbursim tek fermerët dhe agrobizneset. Kostot e tjera fikse mbeten të njëjta për funksionimin e AZHBR. Në vitin 2017 kanë përfituar 1,165 fermerë dhe agrobiznese nga 11,000 të planifikuar (sqarojmë se numri 11,000 përfitues në planifikim kishte të përfshirë përfituesit nga mbrojtja e mizës së ullirit dhe fermerët e dëmtuar nga dermatoza nodulare që u mbështetën me lopë të ardhura nga importi, sikurse sqarohet në materialin më sipër).

## **E. Vrojtime statistikore.**

Për këtë vit buxhetor, lidhur me vrotimet statistikore janë parashikuar dhe alokuar 10,000 mijë lekë dhe janë shpenzuar 8,022.096 mijë lekë ose 80.2% e fondit të alokuar. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar vrotimi bujqësor vjetor 2017; dy parashikime të prodhimit bujqësor dhe blegtoral dhe dy vrojtime të agro-industrisë për vitin 2017.

## **F. Fara gruri, misri, patate, perime të tjera, bimë medicinale, etj, të analizuarra, testuar dhe certifikuarra.**

Ky produkt realizohet përmes Entit Shtetëror të Farnave dhe Fidanëve. Në buxhetin e rishikuar për vitin 2017 për këtë produkt u alokuar 26,464.5 mijë lekë dhe janë shpenzuar 22,271.791 mijë lekë ose 84.2% e fondit të alokuar. Gjatë vitit 2017 janë certifikuar 10,200,000 fidanë dhe 21,000 kv fara dhe janë testuar 40 variete bimësh.

## **G. Njësi vreshti dhe ullishte të regjistruara.**

Gjatë vitit 2017 janë planifikuar të regjistrohen rreth 10 mijë njësi vreshtash dhe ullishtash (në kadastrat përkatëse) nga QTTB Fushë Krujë. Fondi i alokuar 20,000 mijë lekë dhe shpenzuar 19,771.105 mijë lekë ose 98.86% e fondit të alokuar. Nga shpenzimi i këtij fondi u realizua rregjistrimi në kadastrën përkatëse i 4,568 njësi vreshti nga 4,500 që ishte plani; gjithashtu në kadastrën e ullirit janë rregjistruar 6,669 njësi ullishtash nga 6,600 që ishte plani. Pra, në total nga 11,100 njësi të planifikuara gjatë vitit 2017 janë rregjistruar 11,237 njësi vreshti dhe ullishtash.

## **I. Përmirësim i jetesës në zonat rurale, përmes ndërhyrjes me fonde të donatorëve të huaj.**

Për vitin 2017 vazhdojnë të veprojnë një sërë projektesh si: “Krijimi i Fondit të garancisë për kreditë rurale IPA 2012”; “Mbështetje për modernizimin e Sektorit të Blegtorisë në Shqipëri, IPA 2013”; Protokolli Italian “Programi Fuqizimi i Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural për disbursimin e granteve në bujqësi”; Protokolli Italian “Programi për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të ullinjve”; Protokolli Italian “Projekti pilot për krijimin e eksperimentimit të një sistemi të sigurimeve të lehtësuara për mbulimin e rrezeve në bujqësi”; Projekti SARED “Mbështetje për Bujqësinë & Zhvillimin Ekonomik Rural”; IPA 2013 “Mbështetje për bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, Mbështetje për Përmytjet”; “Projekti Mjedisor”; Grandi Francez “Projekti për Biodiversitetin”; “Mbështetje për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, IPARD LIKE I”; dhe Projekti “IPARD II”.

Për zbatimin e këtyre projekteve sipas buxhetit të rishikuar të vitit 2017 janë alokuar 1,467,160 mijë lekë dhe u përdorën 1,376,540.408 mijë lekë ose rreth 94% e fondit të alokuar.

Informacioni mbi Projektet që veprojnë në fushën e Bujqësisë dhe të Zhvillimit Rural është si vijon:

### **1. Krijimi i Fondit të garancisë për kreditë rurale IPA 2012**

Projekti ka përfunduar aktivitetet e tij në fund të vitit 2016. Nga Delegacioni i EUD Tiranë është bërë pagesa e fundit në drejtim të këtij projekti.

Aktivitetet e realizuara për periudhën:

- Përgatitja e Manualeve të nevojshme si ai Operacional, Financiar, i Prokurimeve, Investimeve, Teknologjisë së Informacionit dhe Manuali i Burimeve Njerëzore. Fodi i garancisë (RCGF) ka implementuar sistemin AlphaWeb për menaxhimin financiar dhe ndërtimin e raporteve financiare. Në mënyrë të vazhdueshme RCGF janë realizuar takime me institucionet relevante, për forcimin e bashkëpunimit të ardhshëm. Aktualisht janë trajtuar



550 pjesëmarrës, bashkëpunuar me NOA, FED Invest, Credins Bank dhe BKT. Fondi i garancisë ka lidhur kontrata me këto institucione:

- NOA - fondi i garancisë 1.25 mln Euro, janë dhënë 367 kredi;
- FED Invest - fondi i garancisë 1.25 mln Euro, janë dhënë 499 kredi;
- Credins Bank - fondi i garancisë 31.5 mln lekë, janë dhënë 27 kredi dhe
- BKT - fondi i garancisë 0.7 mln lekë, janë dhënë 7 kredi.

## **2. Mbështetje për modernizimin e Sektorit të blegtorisë në Shqipëri, IPA 2013**

Nën këtë projekt është nënshkruar: **Kontrata 1 "Përmirësimi i performancës dhe cilësisë së shërbimit ekstensiv publik në sektorin e blegtorisë"**.

- Aktiviteti ka filluar në 8 Maj, 2017. Ka përfunduar faza fillestare për këtë kontratë. Është miratuar Raporti Paraprak (Inception Report) dhe vijon puna për realizimin e objektivave sipas aktiviteteve të përcaktuara. Projekti ka vazhduar punën për rishikimin e website të IPESA, për të cilën është hapur edhe adresa [https:// www.facebook.com/ IPESA-Project-Albania-1086171661520048/](https://www.facebook.com/IPESA-Project-Albania-1086171661520048/).
- Në kuadër të këtij projekti është zhvilluar një studim për ristrukturimin e Shërbimeve Këshillimore sipas modelit kroat; është shpërndarë një pyetësor me qëllimin vlerësimin e njohurive të përgjithshme të fermerëve dhe ekstensionistëve në lidhje me nevojat për trajnim, mjetet e përdorura të ekstensionit, aktivitetet e zhvilluara prej tyre, si dhe problematikat e hasura, të cilat prekin ecurinë e fermave. Subjektet e pyetësorit ishin 16 ekstensionistë dhe 26 fermerë, të cilët u përzgjedhën në mënyrë rastësore nga lista e fermerëve të shërbimeve të ekstensionit në rajonin e Elbasanit, Gjirokastrës, Lushnjës dhe Shkodrës;
- Ekipi i projektit është në procesin e planifikimit të metodologjisë dhe moduleve të trajnimeve të Shërbimit Publik të Ekstensionit; në këtë kuadër është hartuar edhe drafti i moduleve të trajnimit;
- Më datë 7 dhjetor, 2017 është dorëzuar Raporti i 6-mujorit të parë (Interim Raporti I) së bashku me Raport Vlerësimin për Shërbimin Publik Ekstensiv, Njohuritë Bujqësore dhe Informacionin/ Sistemin Inovativ.

## **Kontrata 2: Dizenjimi i 2 ndërtesave në Qendrat e Transferimit të Teknologjisë Bujqësore të Fushë-Krujës dhe Korçës**

Procedura e tenderimit rezultoi pa fitues për shkak të ofertave të dobëta teknike. Nga MBZHR është propozuar përfshirja e shumës së kësaj procedure në buxhetin e vitit 2018.

### **Problematika e hasur:**

Raportimi mbi realizimin financiar të këtij projekti do bëhet nga Fondi Kombëtar (sipas Udhëzimit nr. 10 datë 09. 03. 2015). Për këtë projekt nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është raportuar bazuar në nivelin e disbursimeve sipas tabelave përkatëse të përcaktuara në kontratë.

## **3. Projekti Adriatik-Jon-Valorizimi i produkteve agro-bujqësore**

Vazhdon komunikimi me partnerët e tjerë të përfshirë nën këtë nismë. Nuk ka problematika.

## **4. Protokollit Italian - Programi - Fuqizimi i Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural për disbursimin e granteve në bujqësi**

Është firmosur marrëveshja në datë 8 Shkurt 2017 për asistencë tekniko-ligjore dhe institucionale ndërmjet MBZHRAU dhe MIPAAF; Është përgatitur plani i punës si dhe kanë filluar misionet e para të ekspertëve MIPAAF për vënien në zbatim të kësaj marrëveshjeje;

## **5. Protokollit Italian-Programi për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të ullinjve**

Projekti ka filluar të jetë operativ prej datës 2 Mars 2015.

- Në mënyrë të vazhdueshme janë kryer takime dhe janë mbajtur marrëditjet me të gjitha palët e interesit, drejtoritë dhe institucionet që duhet të bashkëpunojnë me projektin. Kemi qene aktive dhe ne aktivitetet e organizuara për të qene sa me pranë sektorit të ullishtarisë shqiptare.
- Jane lancuar procedurat e tenderimit sipas planit të prokurimit të miratuar nga KD.
- Duhet theksuar se: është konkluduar negociimi me CIHEAM-Bari, organizëm ndërqeveritar.
- Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje, datë 06. 02. 2017. Rëndësia e këtij bashkëpunimi dhe rezultatet e pritshme janë të pasqyruara dhe të detajuara dhe në dokumentet e projektit sipas komponentëve përkatës.

#### **6. Protokollit Italian-Projekti pilot për krijimin e eksperimentimit të një sistemi të sigurimeve të lehtësuara për mbulimin e rreziqeve në bujqësi**

- Ka përfunduar dhe është lidhur marrëveshja me MIPAAF për një nga procedurat kryesore të tenderimit;
- Janë shkëmbyer Nota Verbale ndërmjet institucioneve Italo - Shqiptare për amendimin e rialokimit të fondeve për projektin.
- Po shqyrtohet një mënyrë strategjike për përfshirjen e sektorit privat të sigurimeve në skemën e sigurimeve që synon të krijojë projekti ASSI.

#### **7. Projekti SARED "Mbështetje për Bujqësinë & Zhvillimin Ekonomik Rural"**

- Kanë aplikuar gjithsej 615 aplikantë në 4 thirrje me një fond total 8.7 mln Euro. Janë kryer fushata në TV, media; organizuar takime me 950 pjesëmarrës; janë rritur kapacitetet për 1000 familje; janë promovuar eksportet dhe janë mbështetur 30 aplikantë për standardet e cilësisë Global (GAP). Është në proces puna për aplikimet nën thirrjen e 4-rt, ku është realizuar thirrja për grande në investime për 3 zinxhirët bujqësor të vlerës. Deri në fund të dhjetorit 2017, nën thirrjen e 4-rt, nga 269 aplikantët e kontraktuar, 196 prej tyre i kanë përfunduar investimet dhe për ta janë kryer edhe pagesat.
- Përsa i përket rritjes së kapaciteteve mbështetja vazhdon në drejtim të konsolidimit të 55 grupeve të veprimit sipas zinxhirëve të vlerës (VC-AGs), ndërkohë që mbështetja është zgjeruar me 3 grupe të tjera, pra aktualisht mbështeten 58 VC-AGs (mesatarisht 20 pjesëmarrës (familje) për çdo grup.
- MBZHR u asistua për të zhvilluar një web page të shërbimit këshillimor (www.agri.al), e cila u lancua në Maj 2017 dhe që përmban një sistem të parashikimit të sëmundjeve në pemëtoret. Për më tepër SARED vazhdon bashkëpunimin me gazetën e publikuar nga KASH ku rregullisht publikohen artikuj mbi teknologjitë e reja, tregjet që lidhen me Zinxhirët e Vlerave që mbështet SARED; rreth 20 artikuj janë publikuar këtë vit, me kontribut të VC-AGs të sipërpërmendur.

#### **8. IPA 2013 - Mbështetje për bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, Mbështetje për Përmbytjet**

- Lidhur me nën komponentin e Grandit të Kompensimit, janë kompensuar deri tani 3417 fermerë në 5 Rajone (Vlorë, Fier, Gjirokastrë, Berat dhe Korçë). Në pritje të kompensimit të fermerëve të tjerë ende të pakompensuar.
- Në Nën komponentin - Grand Investimi, nga 28 kontrata të pranuar për financim janë lidhur 6 kontrata.
- Në kuadër të komponentit të asistencës teknike, janë kryer trajnimet sipas planit të aktivitetëve kryesisht me procesin e monitorimit të grandëve të kompensimit direkt si dhe me PDNA. Në proces puna për plotësimin e aktivitetëve të tjera sipas planit të aktivitetëve.
- Publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë, raporti i monitorimit të përmbytjeve.
- Ka përfunduar draft raporti i auditimit për këtë projekt. Në pritje të rishikimit dhe konsolidimit të këtij raporti.

## **Problematika e hasur:**

- Hera e parë e zbatimit të një grandi direkt për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Mbyllje të parakohshme të llogarive bankare nga fermerët;
- Mungesa e atësisë dhe kartës së identitetit solli probleme evidentimin e fermerit përfitues si dhe gabime ortografike etj.
- Nën grandin e investimeve: Aplikantët kanë hasur në vështirësi, për sigurimin e lejes së ndërtimit nga institucionet përkatëse. Konkretisht 4 aplikantë janë tërhequr nga aplikimi.

Problematikë, e cila kërkon zgjidhje të menjëhershme: Është kërkuar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, transferimi i fondit të planifikuar për transhin e dytë për këtë projekt për vitin 2018, kërkesë për të cilën ende nuk kemi marrë njoftim mbi hapat e ndjekura deri tani.

## **9. Mbështetje për bujqësinë dhe Zhvillimin Rural- IPARD LIKE**

Pritet finalizimi i raportit përfundimtar nga EUD pasi projekti është mbyllur në Prill 2017.

## **10. Programi - IPARD II**

Është dërguar lista e shpenzimeve të pranueshme për programin IPARD II mbas konsultimeve me Agjencinë IPARD dhe Dg. Agri është dërguar për aprovim zyrtar në Komisionin Evropian me datë 19 Qershor 2017.

## **11. STF Projekti Mjedisor Banka Botërore**

- Ka përfunduar vlerësimi i granteve dhe pritet finalizimi i realizimit të fondeve. Për këtë vit nuk ka patur shpenzim të fondeve.
- Bazuar në Manualin Operacional të Grandeve, është bërë thirrja publike për aplikim dhe në total kanë aplikuar 137 subjekte, nga të cilat 125 Shoqata dhe 12 Individ.
- Aktualisht janë përzgjedhur 66 subjekte dhe janë skualifikuar 71. Të gjithë aplikantët e përzgjedhur janë trajnuar për zbatimin e rregullave të prokurimit sipas Manualeve të Bankës Botërore.

## **IBRD Projekti Mjedisor Banka Botërore**

Nuk ka realizim për vitin 2017.

- Projekti është në proces zbatimi. Në kuadër të këtij Projekti është krijuar softi për menaxhimin e informacionit. I gjithë stafi IPARD i AZHBR është trajnuar për përdorimin e këtij softi.

## **Problematikat e hasura:**

- Mungesa e Ofertave standarde në dosjet e aplikimeve ka çuar në vonesa të kontrollit administrativ të dosjeve, duke kërkuar dokumente shtesë dhe standardizim të ofertave;
- Tatimi në burim 15 % i paraqitur nga aplikantët në Projekt Propozim ishte i paparashikuar në Manualin Operacional. Në bazë të Ligjit Nr. 8438, datë 28. 12. 1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, AZHBR ka marrë konfirmim nga Tatimet, se këto Organizata (OJF), nuk janë subjekt i Tatimit në Burim;

## **12. Grandi Francez "Projekti për biodiversitetin"**

Projekti është në vitin e fundit të implementimit të tij. Janë realizuar pothuajse të gjitha aktivitetet fizike. Konkretisht janë realizuar aktivitetet e mëposhtme:

- Inventarizim i produkteve potenciale në zonën malore për tu mbështetur në procesin e regjistrimit të shenjës së cilësisë - në masën 100%;
- Përmirësimi i kapaciteteve institucionale dhe legjislacionit që ka të bëjë me markat kolektive dhe shenjat e cilësisë në Shqipëri - në masën 90%;
- Zhvillimi i zinxhirëve të vlerës për katër produktet “pilote” të rezultuara nga studimet paraprake - në masën 100% (Mishi i Kecave të Hasit; Boronica; Gështenja dhe Mialti i

Gështenjës); regjistrime të produkteve (1 regjistrim për Kecat e Hasit, 2 për boronicën (Tropojë dhe Kukës), 2 për gështenjën (në Reç të M. Madhe dhe Tropojë) dhe 2 për mjaltin e gështenjës (në Reç të M. Madhe dhe Tropojë).

- Studime të thelluara në aspekte të mjedisit dhe eko-pastoralizmit, në Shqipëri dhe në rajon (Kosovë dhe Mal të Zi);
- Aktivitete rajonale me aktorë të ndryshëm publik të përfshirë në rrjetin rajonal të shenjave të cilësisë.

## 5. Programi “Këshillimi dhe Informacioni bujqësor”.

Realizimi i shpenzimeve të 12- mujorit të vitit 2017, për këtë program që përfaqëson rreth **2.7 përqind** të totalit të buxhetit fakt të kësaj ministrie dhe sipas zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor të rishikuar, rezulton si më poshtë:

• Shpenzimet korente	96 përqind
• Shpenzimet kapitale	84 përqind
• <b>Gjithsej</b>	<b>95 përqind</b>

Në programin “Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor”, përfshihet financimi i aktivitetit të Qendrave të Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Ekstensionit dhe Informacionit Bujqësor, të cilat ndiqen nga sektori përkatës.

### ***Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB).***

Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB), gjatë vitit 2017 e kanë përqendruar aktivitetin e tyre në realizimin e detyrave të planifikuara sipas programit të punës të miratuar për vitin 2017.

Produktet e parashikuara të këtij programi janë realizuar si vijon:

- **Produkti A:** Teknologji, paketa teknologjike (elemente të përmirësuar) dhe studime të ofruara. Shpenzimet e planifikuara për këtë produkt, në përfundim të vitit 2017, janë realizuar në masën 97%, krahasuar me planin vjetor të shpenzimeve. Për vitin 2017, ishin planifikuar 15 teknologji/paketa teknologjike (elemente të përmirësuar), si dhe 2 studime në fushën e tokave. Aktivitetet që i shërbejnë Produktit A janë studime, teknika dhe teknologji në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë, testime, mirëmbajtje dhe rigjenerime të koleksioneve gjenetike që përdoren për përmirësimin e komponentëve prindëror të farave dhe fidanëve si dhe prodhimin e hallkave të larta që u ofrohen fermerëve me çmime konkurruese.
- **Produkti B:** Ofrim shërbimesh ekstensionit: Shpenzimet për këtë produkt në përfundim të vitit 2017, janë realizuar në masën 97%. Aktivitetet që i shërbejnë Produktit B janë: 22 kërkime në nivel ferme që realizohen nga QTTB-të në bashkëpunim me strukturat e Shërbimit të Ekstensionit në ferma të ndryshme në të gjithë territorin e vendit; trajnime nga QTTB-të, Universiteti Bujqësor dhe Projekte që veprojnë në fushën e bujqësisë në mbështetje të zhvillimit të kapaciteteve për specialistët e Ekstensionit dhe këta të fundit në përmirësimin dhe freskimin e njohurive të fermerëve të interesuar. Nga 140 ditë trajnime të planifikuara për vitin 2017, janë realizuar 140 të tilla; Ishin planifikuar dhe u përgatitën 5 tituj broshurash teknike sipas nevojave të fermerëve.
- **Produkti C:** Të ardhura nga QTTB-të të realizuara.  
Bazuar në Plan bizneset e QTTB-ve për vitin 2017, realizimi i të ardhurave ka ardhur kryesisht nga: prodhimi i farërave dhe fidanëve si inpute të gjeneracioneve të larta, nga realizimi i analizave laboratorike të ushqimit, tokës dhe hartografia, si dhe nga shpërndarja e materialit biologjik për përmirësimin racor të gjedhit në vend, etj.

Përdorimi dhe realizimi i të ardhurave nga QTTB-të gjatë vitit 2017, është në masën 90%. Gjatë këtij viti nga QTTB-të, janë realizuar dhe përdorur 28,779 mijë lekë nga 31,950 mijë lekë të planifikuara përgjatë gjithë vitit. Diferenca në realizim kundrejt planit ka ardhur si pasojë e mosrealizimit të një pjese të ardhurash nga QTTB Fushë Krujë dhe Shkodër.

- **Produkti D:** Magazina Qendër e QTTB Korçë e rikonstruktuar.  
Ky produkt i planifikuar në vlerën 5,000 mijë lekë është realizuar në masën 3,523 mijë lekë, Diferenca vjen si pasojë e prokurimit me vlerë më të ulët të objektit.
- **Produkti E:** Agregatë bujqësor të blerë nga QTTB Lushnjë  
Në këtë produkt ishte planifikuar blerja e 5 agregatëve bujqësor nga QTTB Lushnjë me vlerë totale 1,680 mijë lekë. Ky produkt është realizuar dhe disbursuar në masën 100%.
- **Produkti F:** Pajisje për laboratorin biokimik dhe AND në QTTB Vlorë e blerë.  
Ky produkt i planifikuar në masën 3,000 mijë lekë është në tenderuar. Ky produkt është realizuar dhe disbursuar në masën 100%.
- **Shërbimi i Ekstensionit**  
Gjatë këtij viti, Strukturat e Ekstensionit (Shërbimit Këshillimor) në qarqe kanë qenë të pranishme dhe kanë zhvilluar aktivitete ekstensionit si demonstrime, ditë fushe, takime të tjera në grup, seminare, panaire, tavolina të rrumbullakëta, etj. Këto aktivitete kanë si synim përmirësimin e shprehive praktike dhe njohuritë e fermerëve.  
Nga strukturat e shërbimit Këshillimor janë kontaktuar direkt dhe indirekt dhe kanë marrë informacion gjithsej 66200 fermerë dhe agrobiznese, nga 66,200 fermerë dhe agrobiznese të synuara..

Gjatë vitit 2017, janë realizuar 140 ditë trajnime të hapura me specialistë të bujqësisë nga 140 ditë të planifikuara si dhe 1391 ditë trajnime me pjesëmarrjen e 11,714 fermerëve të interesuar kryesisht për çështje teknike, ekonomike, të kooperimit, marketingut, për ndryshimet klimatike etj.

Po kështu, janë shpërndarë për të interesuarit 37,857 copë fletëpalosje për probleme të ndryshme të teknologjisë në bimë e kafshë, kooperimit bujqësor, menaxhimit të integruar të fermës, etj.

Janë realizuar 121 kronika dhe emisione televizive në TV kombëtare dhe lokale.

Gjithashtu për vitin 2017, me fondin e planifikuar për realizimin e trajnimeve gender me gra fermere, nga QTTB Fushë-Krujë, Korçë dhe Vlorë u realizuan 5 ditë trajnime me pjesëmarrjen e grave fermere në rrethet Peshkopi, Korçë, Pogradec, Vlorë dhe Sarandë (Mursi).

## 7. Programi “Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës Bujqësore”

Realizimi i shpenzimeve të 12- mujorit të vitit 2017 për këtë program, që përfaqëson **0.3 %** të realizimit të kësaj ministrie, sipas zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor rezultoi si më poshtë:

• Shpenzimet korente	100	përqind
• Shpenzimet kapitale	0	përqind (pasi nuk ka)
• <b>Gjithsej</b>	<b>100</b>	<b>përqind</b>

Janë parashikuar për këtë periudhë 2 produkte në këtë program, të cilat rezultojnë të plotësuara si më poshtë.

Produkti	Buxheti 2016 në mln	Realizimi i 12 mujorit		
		Në milion	Në %	Statusi i realizimit
Krijimi Lis/GIS (QTTB	23.5	23.5	100	plotesisht
Dixhitalizim RTB (firma	1.5	1.5	100	plotesisht
<b>TOTALI</b>	<b>25</b>	<b>25</b>	<b>100</b>	

Për vitin 2017, për krijimin e sistemit të informacionit për tokën (LIS) dhe integrimin në sistemin e informacionit (GIS) u realizuan në rreth 60 000 ha tokë bujqësore në njësitë administrative të Qarkut Vlorë, Berat dhe Korçë me një fond prej 23.5 milion lekë dhe Dixhitalizimi i Regjistrimit të Tokës Bujqësore (RTB) do të realizohet në 20 njësi administrative vendore me një fond prej 1.5 milion lekë.

Ky sistem do të shtrihet në njësitë administrative:

-Cukallat, Lumas, Roshnik, Sinjë, Tërpan, Ura Vajgurore, Velabishtë, Vërtop të qarkut Berat;

-Barmash, Çlirim, Qendër Leskovik, Mollas, Novoselë, Qendër Ersekë të qarkut Korçë;

-Armen, Kotë, Novoselë, Qendër Vlorë, Selenicë, Sevaster, Shushicë, Vllahinë, Delvinë, Finiq, Mesopotam, Vergo, Aliko, Dhivër dhe Livadhja të qarkut Vlorë.

Në kuadër të programit “Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës Bujqësore” gjatë 8 mujorit janë realizuar takime në bashkitë Berat, Delvinë, Finiq, Kolonjë, Poliçan, Selenicë dhe Vlorë, duke prezantur objektivat e programit për vitin 2017, kjo e mbështetur në planin e punës së miratuar, sipas objektivave të programit.

Si 12-mujor janë realizuar detyrat e mëposhtme:

#### 1. Inventarizimi dhe klasifikimi i tokave bujqësore sipas përshtatshmërisë së saj:

- Lidhja e aktmarrëveshjeve midis bashkive të sipërpërmendura dhe Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Fushë Krujë në të cilat janë përcaktuar detyrime e ndërsjellëta gjatë procesit të realizimit të programit,
- Skanimi dhe gjeoreferencimi i hartave topografike ushtarake me shkallë 1:25 000,
- Rikonicioni i terrenit dhe përcaktimi në hartë i vendeve ku do të kryhen sondimet e tokës për njësitë administrative Cukalat dhe Vërtop,
- Fillimi i studimit fushor për vlerësimin e tipeve dhe përshtatshmërisë së tokës bujqësore për njësitë administrative Cukalat dhe Vërtop,

#### 2. Mbledhja e informacionit për përdorimin/mbulesë tokësore për vitin që është kryer regjistrimi fillestar dhe 2017 si dhe analizimi i dinamikës së ndryshimeve në përdorimin e tokës bazuar te parcela:

- Sigurimi i informacioni dixhital kartelë-hartë nga ZQRPP-ja,
- Hedhja në formë dixhitale e përdorimit të tokës për vitin 2017 në njësitë administrative Cukalat dhe Vërtop,
- Dixhitalizimi i ndërtesave dhe rrugëve për njësinë administrative Cukalat dhe Vërtop.

#### 3. Studimi agro-ekologjik i zonave në studim

- Përgatitja e pyetsorëve agro-ekologjik për njësinë administrative,
- Plotësimi i pyetsorëve agro-ekologjik në njësinë administrative Cukallat,



- Fillimi i punës në terren për verifikimin e skemave ujitëse dhe kulluese në njësitë administrative Cukalat dhe Vërtop,
- Fillimi i punës në terren për mbledhjen e treguesve tokësore që ndikojnë në rrezikun e erozionit potencial dhe aktual të tokës njësitë administrative Cukalat dhe Vërtop.

#### 4. Dixhitalizimi i pjesshëm i regjistrit të tokës bujqësore

- Përgatitja Termave të Referencës me objekt “Dixhitalizimin e Regjistrit të tokës bujqësore për 20 njësi administrative të vendit”.

#### 5. Krijimi i Sistemit të Informacionit për Tokën në 21 njësi administrative të qarkut Berat, Korçë dhe Vlorë

- Përgatitja Termave të Referencës me objekt “Krijimi i Sistemit të Informacionit për Tokën Bujqësore LIS i Integruar në GIS në 21 Njësi Administrative”

#### **Programi “Menaxhimi i Peshkimit”**

Realizimi i shpenzimeve të 12-mujorit të vitit 2017 për këtë program, që përfaqëson **1.2 përqind** të realizimit të kësaj ministrie, sipas zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet korente 99 përqind
- Shpenzimet kapitale 4.5 përqind
- **Gjithsej 94 përqind**

Nga monitorimi i produkteve të buxhetit për 12 mujorin e vitin 2017 për Programin “Mbështetje për Peshkim”, janë parashikuar për produktet e mëposhtëme të cilat rezultojnë të plotësuara si më poshtë.

Produkti B: Akte ligjore dhe nënligjore për burimet peshkore

Plani per vitin 2017:	1000 mijë LEK	Fakti per vitin 2017:	500 mijë LEK
Plani per vitin i produktit:	5	Fakti per vitin 2017	5

Përmirësimi i kuadrit ligjor është një prioritet me qëllim arritjen e standarteve të BE-së në lidhje me menaxhimin e sektorit dhe me sigurinë dhe cilësinë e produkteve.

Produkti C: Sistemi i kontrollit të monitorimit të mjeteve të peshkimit (Blu box).

Plani per vitin 2017:	13.000 mijë LEK	Fakti per vitin 2017:	4.337 mijë LEK
Plani per vitin i produktit:	1 sistem	Fakti per vitin 2017 :	1 sistem

Ky sistem ka për qëllim të sigurojë vëzhgimin e hapësirës detare shqiptare, për të realizuar organizmin, planëzimin, bashkërendimin dhe drejtimin e operacioneve në det, në përputhje me legjislacionin detar kombëtar dhe ndërkombëtar.

Produkti F: Menaxhimi i infrastrukturës.

Plani për vitin 2017:	48,000 mijë lekë	Fakti për vitin 2017	62,356 mijë lekë
Plani për vitin i produktit:	4 porte	Fakti per vitin 2017 :	4 porte

Menaxhimi i porteve është një proces në vazhdimësi për të katër portet e peshkimit: në Durrës, Shëngjin, Vlorë dhe Sarandë.

Produkti G. Rasate të peshkimit të kultivuara në Ekonomitë e Linit dhe të Zvezdës.

Plani për vitin 2017:	13,000 mijë lekë	Fakti për vitin 2017:	13,000 mijë lekë
Plani për vitin i produktit:	400.000 rasate	Fakti për vitin 2017	400.000 rasate

Ka perfunduar procesi

Produkti H. Kontrolle te inspektoriatit te peshkimit në subjektet e peshkimit te licensuara.

Plani per vitin 2017:	12,000 mijë lekë	Fakti për vitin 2017:	12,000 mijë lekë
Plani për vitin:	1800 kontrolle	Fakti per vitin 2017	1800 kontrolle

Me qëllim zbatimin e Ligjit të Peshkimit Nr.64/2012 dhe në zbatim të Rregulloreve përkatëse për një shfrytëzim sa më të mirë të burimeve peshkore, kryehet procesi i monitorimit dhe kontrollit në lidhje me zbatimin e kushteve të vendosura në lejet për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit si në det dhe në ujërat e brendshme dhe akuakulturë.

### **Programi :Administrimi i Ujrave**

Realizimi i shpenzimeve të 12 mujorit të vitit 2017 për këtë program, që përfaqëson **3.2 %** të realizimit të kësaj ministrie, sipas zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet korente 96 përqind
- Shpenzimet kapitale 87 përqind
- **Gjithsej 91 përqind**

Programi i Administrimit të Ujrave mbështet administrimin e burimeve ujore si një nga burimet natyrore me të rëndësishëm dhe të domosdoshëm për jetën dhe zhvillimin social-ekonomik të vëndit, për një zhvillim të qëndrueshëm të rezervave ujore, për të kufizuar ndotjen e ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore nga aktivitetet e veprimtarive industriale, bujqësore dhe aktiviteve të popullsisë në zonat rurale dhe urbane, që shkaktojnë dëmtim të ekosistemeve ujore, si dhe të lumenjëve nga shfrytëzimi pa kriter i tyre. gjithashtu mbështet bashkëpunimin në nivel ndërkombëtar për administrimin e rezervave ujore, që shtrihet në kufijtë midis vendeve. Ndarja e shpenzimeve faktike të programit sipas artikujve për buxhetin per vitin 2017 është bazuar në;

Përcaktimin e produkteve si prioritete duke synuar në përmirësimin dhe forcimin e kuadrit ligjor për menaxhimin e integruar të burimeve ujore, ujërave sipërfaqësorë, qofshin të përkohshem apo të përhershëm, të ujërave të brendshme detare, ujërave ndërkufitare, të ujërave nëntokësore dhe të statusit të tyre, si dhe përafrimi i legjislacionit tonë me atë të Bashkimit Europian, Jane miratuar 6 akte nenligjore ne zbatim te ligjit 111/2012, pra realizimi I ketij produkti eshte ne masen 60%.

Rehabilitimin e shtretërve të lumenjeve si rezultat i aktivitetit të subjekteve që shfrytëzojnë inerte lumore është realizuar në masën 70%

Realizimin e te ardhurave nga perdoruesit e burimeve ujore me leje.

Raportimi çdo 3-mujor nga ABU-te dhe rakordimi çdo muaj me Degen e Finances se

MBZHRAU.

Realizimin e marrveshjeve për ujërat ndërkufitare me vëndet fqinje në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtëme. Janë organizuar takime me vëndet fqinje por akoma nuk është realizuar ndonjë marrveshje për ujërat ndërkufitare. Eshte ne perfundim marrveshja me Malin e Zi.

Monitorimin e procedurës së paisjes me leje të përdoruesve të burimeve ujore.

Me miratimin e akteve nënligjore ka filluar procedura e plotesimit dhe monitorimit te dosjeve te subjekteve, si dhe jane pajisur me leje te gjithë aplikantët, përdorues të burimeve ujore

Inspektimin dhe verifikimin e kushteve në lejet e miratuara nga KBU-ja, për përdoruesit e burimeve ujore, konform legjislacionit në fuqi, marrja e masave për mbrojtjen e tyre. 85%

Inspektimin për evidentimin e të gjithë përdoruesve të burimeve ujore pa leje, evidentimi i të gjithë burimeve ujore nëntokësore (pus-shpime) dhe sipërfqaqësore, si dhe për shfrytëzimin pa leje të inerteve lumore. 85%

Monitorimin dhe rakordimin e punës me ABU për implementimin e legjislacionit.

Pregatitjen e Kadastrës së burimeve ujorene masen 100%, Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore 98% dhe pregatitjen e planeve të menaxhimit të baseneve ujore Drin-Bunë dhe Seman ne masen 60%.

*Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin.*

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

**Aurora Alimadhi**

Konceptoi:Adriana Nasi

Pranoi: Entela Kola, P/S/Buxhetit

Miratoi: Agron Vata, Dr. Financës,